



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVA

KUVENDI / SKUPŠTINA / ASSEMBLY

Legjislatura III

Kuvendi i Kosovës,

Në bazë të kreut 9.1.26 të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/09 e datës 15maj 2001), dhe në pajtim rregullën 32 dhe 61 të Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës,

Duke marr parasysh Deklaratën e Kuvendit të Kosovës, të datës 5 prill 2007 me të cilën pranohen të gjitha përgjegjësitë dhe obligimet të përcaktuara në Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, të parashtruar para Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, duke u zotuar për implementimin e plot të tij dhe duke i konsideruar dispozitat e përfshira në Propozimin Gjithëpërfshirës si të obligueshme për Kosovën,

Duke qenë në dijeni për rrethanat e jashtëzakonshme dhe natyrën e veçantë të Legjislacionit që duhet miratuar dhe duke marrë parasysh që është ndërmarrë një proces i veçantë, përfshirë edhe konsultime të gjëra ndërmjet të gjitha palëve,

Kuvendi i Kosovës në seancën plenare të mbajtur më 15 shkurt 2008

V E N D O S I

Për shmangie nga Rregullorja e Punës për të mundësuar që t'i konsiderojë, adresojë dhe miratojë ligjet e identifikuara në Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës dhe Legjislacionin e ndërlidhur me të në mënyrë ekskluzive sipas procedurës në vijim:

- 1) Pasi që një apo më shumë nga ligjet e cekura më lart janë paraqitur për shqyrtim dhe veprime të Kuvendit, leximi i parë i tyre do të bëhet brenda 24 orëve nga paraqitja formale e tyre. Brenda 24 orëve, ligjet e tilla do të shqyrtohen nga Komisioni ad hoc, i themeluar me qëllim të ndërmarrjes së shqyrtimit të tillë të të gjitha ligjeve të cekura më lart. Pa paragjykuar kontributin e kërkuar nga komisionet kryesore, Komisioni ad hoc do t'i përmbushë përgjegjësitë që zakonisht u caktohen komisioneve funksionale. Leximi i Dytë dhe i fundit, si dhe aprovimi i ligjeve do të bëhen pas rishqyrtimit nga Komisioni ad hoc dhe jo më vonë se 2 ditë pas paraqitjes formale të ligjeve në Kuvend.

- 2) Komisioni ad hoc do të përbëhet nga 9 anëtarë, duke pasur parasysh përfaqësimin e barabartë e të gjitha komuniteteve. Përbërja do ta reflektojë përfaqësimin në Kryesinë e Kuvendit.
- 3) Komisioni ad hoc do të ketë për detyrë të siguroj pajtueshmërinë e brendshme të ligjeve dhe përputhshmërinë në mes të versioneve në gjuhë të ndryshme. Propozimet për ndryshime të natyrës përmbajtjesore do të ndërmerren vetëm nga Komisioni ad hoc, nëse konsiderohen të nevojshme dhe atë nga 2/3 e anëtarëve të Komisionit ad hoc.
- 4) Ndryshimet e propozuara dhe të aprovuara nga Komisioni ad hoc, formalisht do të aprovohen nga Kuvendi pas kërkesës së përkrahur nga shumica e anëtarëve të Kuvendit. Asnjë ndryshim përpos atyre të prezantuara nga Komisioni ad hoc nuk do të merret në konsiderim nga Kuvendi. Pas miratimit, ligjet do të hyjnë në fuqi pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës dhe pas nënshkrimit nga Presidenti i Republikës së Kosovës.
- 5) Pas rishikimit nga Komisioni ad hoc dhe vetëm sipas kërkesës, çdo grupi parlamentar do t'i lejohen 5 minuta për komente gjatë leximit të dytë.
- 6) Deklarata e shpenzimeve do t'i bashkëngjitet çdo ligji të paraqitur në Kuvend. Deklarata e tillë do të plotësohet me dorëzimin formal të Formës për Ndikimin e Vlerësimin Financiar brenda 60 ditëve nëse është e mundur dhe jo më vonë se 180 ditë pas miratimi të ligjit. Kjo Deklaratë do t'i përmbushë kërkesat e ligjit në fuqi.

V-014

Prishtinë, më 15 shkurt 2008

Kryetari i Kuvendit të Kosovës
Jakup KRASNIQI

Vendimi i dërgohet:

- Qeverisë së Kosovës,
- Anëtarëve të Komisionit Ad Hoc,
- Arkivit të Kuvendit.